

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-25-4780-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtina
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	+38344467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	24.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

“Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”

Njoftim për kontratë: 29.05.2025

Dosja e tenderit: 29.05.2025

Dosja e tenderit: 20.06.2025

**Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara:
01.07.2025**

Dosja e tenderit: 01.07.2025

Kërkesë për rishqyrtim – PBC: 02.07.2025

**Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara:
03.07.2025**

Dosja e tenderit: 03.07.2025

Vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim: 03.07.2025

**Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara:
14.07.2025**

Dosja e tenderit: 14.07.2025

Përshkrimi i çmimeve – forma e korrigjuar: 14.07.2025

Hapja e ofertës: 18.07.2025

Njoftim mbi vendimin e AK-së: 26.08.2025

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm – PBC: 26.08.2025

Kërkesë për rishqyrtim – Inspired Tech Sh.P.K.: 28.08.2025

Vendimi i rishqyrtimit – Inspired Tech Sh.P.K.: 02.09.2025

Ankesa në OSHP – Inspired Tech Sh.P.K.: 10.09.2025

Njoftim mbi vendimin e AK-së: 03.12.2025

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm – PBC: 03.12.2025

Kërkesë për rishqyrtim – Inspired Tech Sh.P.K.: 08.12.2025

Kërkesë për rishqyrtim – CMD: 08.12.2025

Vendimi i rishqyrtimit – Inspired Tech Sh.P.K.: 16.12.2025

Vendimi i rishqyrtimit – CMD: 16.12.2025

Ankesa në OSHP – Inspired Tech Sh.P.K.: 26.12.2025

Njoftim mbi vendimin e AK-së: 06.03.2026

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm – PBC: 06.03.2026

Kërkesë për rishqyrtim – PBC Sh.P.K.: 10.03.2026

Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 18.03.2026

Vendimi i OSHP-së që lënda të kthehet në rivlerësim: 28.04.2026

Njoftim mbi vendimin e AK-së: 08.06.2026

Kërkesa për rishqyrtim: 12.06.2026

Vendimi i AK-së për kërkesën për rishqyrtim: 16.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

PBC, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe palë e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, ka shfrytëzuar procedurën paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në pajtim me nenin 108/A të LPP-së.

Më datë 12.06.2026, PBC ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues kundër B58 – Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 10.06.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit informativ të QKKTGJ”, me nr. prokurimi 206-25-4780-2-1-1.

Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës 16.06.2026, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të PBC SH.P.K. si të pabazuar dhe ka vërtetuar B58 – Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 10.06.2026.

Në përputhje me kërkesën, kësaj ankese i bashkëngjitet kopja e Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 16.06.2026, të nxjerrë gjatë kontestit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas nenit 108/A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7,
Neni 59 paragrafët 2 dhe 4,
Neni 69,
Neni 72 paragrafët 1, 2 dhe 3,
Neni 108/A,
Neni 131, lidhur me nenin 105 dhe nenin 117 të Ligjit për Prokurimin Publik,
Neni 38 paragrafët 2, 3, 4 dhe 5,
Neni 63 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Me veprimet dhe mosveprimet e tij, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 7 të LPP-së - parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës;
- nenin 59, paragrafët 2 dhe 4 të LPP-së - ekzaminimin, vlerësimin dhe përgjegjshmërinë e tenderëve;
- nenin 69 të LPP-së - aftësinë teknike dhe/ose profesionale;
- nenin 72, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPP-së - dokumentacionin dhe informacionin shtesë;
- nenin 108/A të LPP-së - zgjidhjen preliminare të mosmarrëveshjeve;
- nenin 131 të LPP-së, lidhur me nenin 105 dhe nenin 117 të LPP-së - moszbatimin e vendimit/urdhrit të OSHP-së;
- nenin 38, paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024;
- nenin 63 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kjo ankesë parashtrohet para OSHP-së në bazë të kompetencave të OSHP-së sipas neneve 105 dhe 117 të LPP-së.

2. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

2.1. Rrjedha relevante e procedurës

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi dhe avancimi i sistemit

informativ të QKKTGJ”, me nr. të prokurimit 206-25-4780-2-1-1.

Me Vendimin nr. 2026/0188, të datës 28.04.2026, OSHP-ja e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e PBC SH.P.K., ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës dhe e ka kthyer lëndën në rivlerësim.

Çështja kryesore për të cilën lënda është kthyer në rivlerësim ka qenë dëshmimi i përvojës së stafit të operatorit ekonomik Inspired Tech SH.P.K. në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pas kthimit të lëndës në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë sërish B58 - Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 08.06.2026, duke rekomanduar për kontratë të njëjtin operator ekonomik, Inspired Tech SH.P.K.

Më datë 12.06.2026, PBC SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër këtij vendimi.

Më datë 16.06.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar dhe ka vërtetuar B58 - Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 08.06.2026.

2.2. Pretendimi i parë ankimor: AK nuk e ka zbatuar në mënyrë reale dhe substanciale Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188

Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrim ligjor që ta zbatojë në mënyrë reale, substanciale, të dokumentuar dhe të arsyetuar Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188, të datës 28.04.2026.

Ky detyrim nuk përmbushet vetëm me nxjerrjen e një raporti të ri formal të rivlerësimit dhe të një B58 të ri me të njëjtin rezultat. Zbatimi i vendimit të OSHP-së kërkon që AK të tregojë qartë se si është kryer rivlerësimi dhe në çfarë mënyre janë adresuar gjetjet e OSHP-së.

Në veçanti, AK është dashur të tregojë:

Për Menaxherin e Projektit

- Nga është marrë lista e projekteve të menaxhuara nga Menaxheri i Projektit në CV, duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne nuk ka listë të projekteve të menaxhuara, siç ka qenë kërkesë e dosjes së fundit, datë 14.07.2025.
- Nga është marrë përvoja e punës prej 5 vitesh, duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne, vetëm në një pikë është shënuar “Menaxher i projekteve”, por nga ajo rezultojnë vetëm 4 vite përvojë.
- Nga është marrë përvoja e punës në projekte të ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Për Dy Zhvilluesit e Softuerit / Programerët

- Për z. Ndrçim Idrizi, nga është marrë përvoja e punës në CV prej së paku tre vitesh në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft

(.NET me SQL Server), duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne mund të dëshmohet përvojë e përgjithshme në zhvillim të softuerit, por jo në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

- Për znj. Diana Llugaxhija, nga është marrë përvoja e punës në CV prej së paku tre vitesh në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), duke qenë se CV-ja mund të dëshmojë përvojë të përgjithshme në zhvillim të softuerit pas diplomimit, por nuk dëshmon qartë përvojën e punës prej së paku 3 vitesh në zhvillimin e softuerit/programim në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Pra:

- si është kryer rivlerësimi;
- cilat dokumente janë marrë për bazë;
- cilat të dhëna konkrete në CV-të e stafit dëshmojnë përvojën e kërkuar;
- mbi cilën bazë faktike dhe ligjore është konstatuar se shkelja e evidentuar nga OSHP është korrigjuar.

Në vend të kësaj, Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 16.06.2026, është mjaftuar me konstatime të përgjithshme se lënda është rivlerësuar dhe se është trajtuar disa herë nga MSH-ja dhe OSHP-ja.

Për më tepër, AK e relativizon Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188 duke theksuar se ky vendim “bie ndesh” me dy vendime paraprake të OSHP-së dhe se lënda është trajtuar disa herë më parë.

Një arsyetim i tillë është ligjërisht i papranueshëm. Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të vlerësojë nëse vendimi i fundit i OSHP-së bie apo jo në kundërshtim me vendime paraprake të OSHP-së. Vendimi i OSHP-së është i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues dhe duhet të zbatohet në tërësi.

Autoriteti Kontraktues nuk mund ta zëvendësojë zbatimin e vendimit të OSHP-së me arsyetimin se lënda është trajtuar më parë. Përkundrazi, në momentin kur OSHP e ka kthyer lëndën në rivlerësim me Vendimin nr. 2026/0188, AK ka qenë i detyruar të kryejë rivlerësim të ri, real, të dokumentuar dhe të arsyetuar, në përputhje me gjetjet dhe urdhërimet e OSHP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit të datës 14.07.2025.

Fakti se AK në vendimin e tij thekson se “nuk ka çka të shtojë më tepër” tregon se rivlerësimi nuk ka qenë substancial dhe se AK nuk ka adresuar çështjen për të cilën lënda është kthyer në rivlerësim.

Prandaj, AK ka shkelur nenin 131 të LPP-së, në lidhje me nenet 105 dhe 117 të LPP-së.

2.7. Elaborim faktik për Menaxherin e Projektit dhe Dy Zhvilluesit e Softuerit /

Programerët

Detajimet në vijim për anëtarët konkretë të stafit paraqiten si elaborim dhe provë e pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim të datës 12.06.2026.

Dosja e Tenderit, përkatësisht versioni i fundit i datës 14.07.2025, mbi bazën e së cilës është dashur të bëhet vlerësimi i ofertave, ka përcaktuar kërkesa dhe dëshmi të qarta për stafin profesional të propozuar nga operatorët ekonomikë.

Këto kërkesa nuk janë formale, por përbëjnë kritere substanciale të aftësisë teknike dhe profesionale. Prandaj, përmbushja e tyre nuk mund të konstatohet vetëm mbi bazën e dorëzimit formal të CV-së, diplomës, kontratës së punës ose marrëveshjes së angazhimit, por duhet të dëshmohet qartë nga përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar.

2.7.1 Menaxheri i Projektit

Për pozitën Menaxheri i Projektit, Dosja e Tenderit versioni i fundit i datës 14.07.2025, ka kërkuar që personi i propozuar të plotësojë këto kërkesa:

Kërkesa:

- I diplomuar ne nga ndonjërin prej drejtimeve: Shkenca kompjuterike, Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike me Telekomunikacion;
- Kërkohet përvoja e punës minimum 5 vite pas diplomimit (pranohet edhe nga niveli Bachelor) në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server),
- I certifikuar me certifikate valide në PMP ose ekuivalente.

Dëshmitë e kërkuara:

- kopje e diplomës;
- CV me listën e projekteve të menaxhuara;
- deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit;
- kontratë pune me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt;
- kopje e certifikatës për menaxhim dhe vegëza përkatëse për verifikim online.

Nga dokumentet e dorëzuara për Menaxherin e Projektit, z. Ernest Culaj, NUK I PËRMBUSH KËRKESAT E PËRCAKTUARA NË DT, për arsyt si në vijim:

- CV-ja e dorëzuar nuk përmban listë të projekteve të menaxhuara, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit;
- CV-ja e dorëzuar NUK dëshmon përvojën e punës prej së paku 5 vitesh pas diplomimit në menaxhim të projekteve; përkundrazi, nga vetë CV-ja rezulton se përvoja e deklaruar si Menaxher i Projektit për periudhën shtator 2019 – gusht 2023 përbën vetëm 4 vite përvojë.
- CV-ja e dorëzuar NUK dëshmon përvojën e punës prej së paku 5 vitesh pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme, përkatësisht projekteve të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Për ta përmbushur këtë kërkesë, dokumentacioni i dorëzuar brenda afatit për dorëzim të tenderëve do të duhej të përmbante CV me listën e projekteve të menaxhuara dhe të dëshmonte qartë përvojën e kërkuar prej minimum 5 vitesh pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Në mungesë të këtyre elementeve në dokumentacionin e dorëzuar brenda afatit, çdo plotësim i mëvonshëm me CV të re, CV të plotësuar, listë projektesh apo dëshmi të reja do të përbënte ndryshim material të ofertës dhe nuk do të mund të përdorej për ta bërë ofertën të përgjegjshme pas afatit.

Provë:

- Dosja e Tenderit, versioni i fundit i datës 14.07.2025;
- CV-ja e dorëzuar për Menaxherin e Projektit, z. Ernest Culaj.

2.7.2 Dy Zhvilluesit e Softuerit / Programerët

Për pozitat Dy (2) Zhvillues të Softuerit / Programerë, Dosja e Tenderit ka kërkuar që personat e propozuar të plotësojnë këto kërkesa:

Kërkesa:

- Bachelor i Inxhinierisë Kompjuterike ose Bachelor i Shkencave Kompjuterike;
- Me përvojë pune minimum 3 vjeçare pas diplomimit, në zhvillimin e softuerit (programim) të projekteve të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Dëshmitë e kërkuara:

- kopje e diplomës;
- CV;
- kontratë pune me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt.

Nga dokumentet e dorëzuara për dy zhvilluesit e softuerit, rezulton se të njëjtit NUK I PËRMBUSHIN KËRKESAT E PËRCAKTUARA NË DT, për arsyet si në vijim:

- CV-ja e dorëzuar për z. Ndriçim Idrizi NUK dëshmon përvojën e punës prej së paku 3 vitesh pas diplomimit në zhvillimin e softuerit/programim në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server). Përkundrazi, nga e njëjta rezulton vetëm rreth 1 vit përvojë pune në .NET me SQL Server, gjatë periudhës kur ka qenë i angazhuar te kompania TABs.
- CV-ja e dorëzuar për znj. Diana Llugaxhija dëshmon përvojë të përgjithshme në zhvillim të softuerit pas diplomimit, mirëpo NUK dëshmon përvojën e punës prej së paku 3 vitesh në zhvillimin e softuerit/programim në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, dokumentacioni i dorëzuar për dy zhvilluesit e softuerit nuk dëshmon në mënyrë

individuale dhe objektivisht të verifikueshme përmbushjen e kriterit minimum 3 vjeçar pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme Microsoft (.NET me SQL Server).

Provë:

- Dosja e Tenderit, versioni i fundit i datës 14.07.2025;
- CV-ja e dorëzuar për Zhvilluesin e Softuerit / Programer, z. Ndriçim Idrizi;
- CV-ja e dorëzuar për Zhvilluesen e Softuerit / Programer, znj. Diana Llugaxhija.

2.8. Pretendimi i nëntë ankimor: Raporti i Rivlerësimit nuk e mbështet vendimin e AK-së

Raporti i Rivlerësimit i datës 08.06.2026 nuk përmban analizë konkrete se si është konstatuar përvoja e stafit pas diplomimit.

Raporti nuk tregon cilat të dhëna në CV janë marrë për bazë, cilat projekte janë konsideruar të ngjashme, cila ka qenë periudha konkrete e angazhimit, si është verifikuar se projektet janë zhvilluar në platformën Microsoft (.NET me SQL Server) dhe si është adresuar konkretisht gjetja e OSHP-së në Vendimin nr. 2026/0188.

Përkundrazi, Raporti i Rivlerësimit dhe Vendimi i AK-së i datës 16.06.2026 i referohen kryesisht dokumentacionit ekzistues, vendimeve paraprahe dhe faktit se lënda është trajtuar disa herë.

Ky qëndrim është i papranueshëm ligjërisht. AK nuk ka pasur për detyrë ta relativizojë Vendimin e OSHP-së, por ta zbatojë atë përmes një rivlerësimi real, të arsyetuar dhe të bazuar në prova.

2.9. Përfundim mbi bazueshmërinë e ankesës

Duke mos zbatuar realisht Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188, duke mos dhënë arsytim konkret se si është konstatuar përvoja pas diplomimit e stafit, duke mos treguar bazën faktike të dokumentuar dhe objektivisht të verifikueshme, si dhe duke rekomanduar përsëri operatorin ekonomik Inspired Tech SH.P.K. pa dëshmuar përmbushjen e kriterëve substanciale të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet 7, 59, 69, 72, 108/A dhe 131 të LPP-së, si dhe nenet 38 dhe 63 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Oferta e OE Inspired Tech SH.P.K. nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme mbi bazën e dokumentacionit dhe arsyetimit aktual.

3. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, provat dhe dispozitat ligjore të cekura më lart, PBC SH.P.K. kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë si të bazuar ankesën e PBC SH.P.K.;
2. Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 16.06.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e PBC SH.P.K.;
3. Ta anulojë B58 - Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 08.06.2026, me të cilin është rekomanduar për kontratë OE Inspired Tech SH.P.K.;
4. Të konstatojë se Vendimi i AK-së i datës 16.06.2026 dhe B58 i datës 08.06.2026

- janë të pabazuara dhe të paarsyetuara;
5. Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësim të mirëfilltë, në përputhje me LPP-në, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit të fundit, datë 14.07.2025.

2.3. Pretendimi i dytë ankimor: Konfirmimi zyrtar i AK-së se nuk ka dokumente shtesë e bën të domosdoshëm vlerësimin vetëm mbi dokumentacionin ekzistues

Me emailin zyrtar të datës 10.06.2026, Autoriteti Kontraktues ka konfirmuar shprehimisht: “Nuk ka ndonjë dokument shtesë në këtë fazë të rivlerësimit.”

Ky konfirmim është me rëndësi vendimtare, sepse dëshmon se pas kthimit të lëndës në rivlerësim me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188, AK nuk ka kërkuar, nuk ka pranuar dhe nuk ka administruar asnjë dokument, dëshmi apo sqarim shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë.

Rrjedhimisht, AK ka qenë i detyruar që rivlerësimin ta bazojë vetëm në dokumentacionin e dorëzuar brenda afatit për dorëzim të tenderëve, ku CV-ja e Menaxherit të Projektit dhe CV-të për dy Zhvilluesit e Softuerit nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit të fundit, datë 14.07.2025, dhe rrjedhimisht oferta e OE Inspired Tech SH.P.K. ka qenë dhe është e papërgjegjshme.

Në këto rrethana, AK nuk ka pasur bazë faktike dhe ligjore për ta konsideruar ofertën e OE Inspired Tech SH.P.K. si të përgjegjshme. Mungesa e listës së projekteve të menaxhuara nga Menaxheri i Projektit, mungesa e përvojës prej 5 vitesh pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), si dhe mungesa e përvojës prej 3 vitesh pas diplomimit për dy Zhvilluesit e Softuerit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), nuk është paqartësi formale, por mungesë e një dëshmie substanciale të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit për vërtetimin e aftësisë teknike dhe profesionale.

2.4. Pretendimi i tretë ankimor: Kërkesat e Dosjes së Tenderit për përvojën e stafit janë kritere substanciale të aftësisë teknike dhe profesionale

Dosja e Tenderit, përkatësisht versioni i fundit i datës 14.07.2025, mbi bazën e së cilës është dashur të bëhet vlerësimi i ofertave, ka përcaktuar kërkesa dhe dëshmi të qarta për stafin profesional të propozuar nga operatorët ekonomikë.

Këto kërkesa nuk janë kërkesa formale. Ato përbëjnë kritere substanciale të aftësisë teknike dhe profesionale sipas nenit 69 të LPP-së. Prandaj, përmbushja e tyre nuk mund të konstatohet vetëm mbi bazën e dorëzimit formal të CV-së, diplomës, kontratës së punës ose marrëveshjes së angazhimit.

Përmbushja e kërkesës duhet të dëshmohet qartë nga përmbajtja e dokumentacionit të

dorëzuar brenda afatit për dorëzim të tenderëve.

Në rastin konkret, kriteri nuk ka qenë vetëm që stafi të ketë CV, diplomë dhe kontratë/marrëveshje angazhimi. Kriteri substancial ka qenë që stafi të dëshmojë përvojë të caktuar pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Për këtë arsye, AK nuk ka mundur ta konsiderojë ofertën e Inspired Tech SH.P.K. të përgjegjshme pa treguar konkretisht:

Për Menaxherin e Projektit

- Nga është marrë lista e projekteve të menaxhuara nga Menaxheri i Projektit në CV, duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne nuk ka listë të projekteve të menaxhuara, siç ka qenë kërkesë e dosjes së fundit, datë 14.07.2025.
- Nga është marrë përvoja e punës prej 5 vitesh, duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne, vetëm në një pikë është shënuar “Menaxher i projekteve”, por nga ajo rezultojnë vetëm 4 vite përvojë.
- Nga është marrë përvoja e punës në projekte të ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).

Për Dy Zhvilluesit e Softuerit / Programerët

- Për z. Ndriçim Idrizi, nga është marrë përvoja e punës në CV prej së paku tre vitesh në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), duke qenë se në CV-në e dorëzuar tek ne mund të dëshmohet përvojë e përgjithshme në zhvillim të softuerit, por jo në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server).
- Për znj. Diana Llugaxhija, nga është marrë përvoja e punës në CV prej së paku tre vitesh në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), duke qenë se CV-ja mund të dëshmojë përvojë të përgjithshme në zhvillim të softuerit pas diplomimit, por nuk dëshmon qartë përvojën e punës prej së paku 3 vitesh në zhvillimin e softuerit/programim në projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server), siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Në mungesë të këtyre elementeve, nuk kemi të bëjmë me paqartësi formale, por me mosdëshmim të kriterit të aftësisë teknike dhe profesionale.

Në mungesë të këtyre dëshmive, B58 i datës 08.06.2026 dhe Vendimi i AK-së i datës 16.06.2026 janë të pabazuara dhe të paarsyetuara.

2.5. Pretendimi i pestë ankimor: Neni 72 i LPP-së dhe neni 38 i Rregullores nuk mund të shërbejnë për të zëvendësuar mungesën e një dëshmie substancialë

PBC nuk konteston mundësinë ligjore të Autoritetit Kontraktues për të kërkuar sqarime

ose plotësime në kuptim të nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Megjithatë, këto dispozita nuk mund të përdoren për të krijuar pas afatit një bazë të re kualifikuese, e cila nuk ka qenë e dëshmuar në ofertën e dorëzuar brenda afatit. Sqarimet dhe plotësimet mund të lejohen vetëm kur ato kanë të bëjnë me dokumente, informata ose rrethana ekzistenca e të cilave ka qenë e fiksuar para afatit për dorëzim të tenderëve dhe që mund të verifikohen objektivisht, pa ndryshuar ndonjë kusht apo aspekt material të tenderit.

Rrjedhimisht, AK nuk ka mundur ta konsiderojë Inspired Tech SH.P.K. të përgjegjshëm pa treguar se kriteret substanciale kanë qenë të dëshmuara në ofertën e dorëzuar brenda afatit.

2.6. Pretendimi i gjashtë ankimor: Vendimi i AK-së është kontradiktor dhe nuk i përgjigjet në mënyrë meritore kërkesës për rishqyrtim

Në vendimin e datës 16.06.2026, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të PBC SH.P.K. si të pabazuar. Megjithatë, arsyetimi i vendimit nuk i trajton në mënyrë konkrete dhe meritore pretendimet kryesore të PBC SH.P.K.

PBC në kërkesën për rishqyrtim ka kërkuar nga AK që, në rast refuzimi, të japë arsyetim të veçantë dhe të detajuar për çështjet kryesore që lidhen me zbatimin e Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0188 dhe me përmbushjen e kriterëve të stafit nga OE Inspired Tech SH.P.K.

Në veçanti, AK është kërkuar të arsyetojë:

- mënyrën se si e ka zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0188;
- bazën ligjore dhe faktike mbi të cilën e ka konsideruar si të përgjegjshme ofertën e OE Inspired Tech SH.P.K.;
- të dhënat konkrete në CV-në e Menaxherit të Projektit mbi të cilat është konstatuar përvoja minimum 5 vjeçare pas diplomimit;
- listën konkrete të projekteve të menaxhuara të marrë për bazë;
- projektet konkrete të natyrës së ngjashme për secilin anëtar të stafit;
- mënyrën e verifikimit se projektet janë zhvilluar në platformën Microsoft (.NET me SQL Server);
- mënyrën e verifikimit të përvojës pas diplomimit për secilin anëtar të stafit;
- arsyet pse pas kthimit të lëndës në rivlerësim nuk është administruar asnjë dokument, dëshmi apo sqarim shtesë.

AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për këto çështje. Përkundrazi, AK ka përdorur formulime të përgjithshme, duke theksuar se procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje me LPP-në dhe se lënda është trajtuar disa herë.

Kjo nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm ligjor dhe faktik. Vendimi administrativ në një procedurë prokurimi duhet të jetë i arsyetuar, i bazuar në prova dhe i verifikueshëm. Në rastin konkret, vendimi i AK-së nuk tregon se si është konstatuar përmbushja e kriterëve substanciale të Dosjes së Tenderit.

Prandaj, AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së, duke cenuar transparencën, trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e drejtë, si dhe nenet 59, 69 dhe 72 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale do të përcaktohen përmes ekspertizës financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*